

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rekord në mjekësi, veshka e derrit funksionon 271 ditë te një pacient – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/rekord-ne-mjekesi-veshka-e-derrit-funksionon-271-dite-te-nje-pacient/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 00:17:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	4 shtator 2026, 08:59:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f63d4da60419f993e9317aacd3cee07f85b03d993cfd1f932a77a90e7401deb1
TEKSTI	f4b0c64efded4fa7d68ddb78e25a5f07135705a1b14f23b5cbadbbb1e79f70a
PAMJA	f4dc2bb70023da616650ce96403e544f391feb9c450f47efed49c25c2d6c314b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	896fd931ca1c408196969075cb2b5488778d67bd4dddf2a53e1c0f7528bd038a
E MËPARSHMJA	a8aa93fa0b2c9b5de20e35e5b4b5fcc3c2a471e93bd4e4cad4eaa9f94683ebd7
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/896fd931ca1c408196969075cb2b5488778d67bd4dddf2a53e1c0f7528bd038a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Pacienti, Tim Andrews, 66 vjeç, vuanë nga sëmundje e avancuar e veshkave si pasojë e diabetit të tipit 2. Ai iu nënshtrua transplantit më 25 janar 2025 në spitalin Mass General Brigham në SHBA.

Andrews tha se transplantin i dha “shpresë” dhe e kurseu për muaj nga nevoja për dializë, procesi përmes të cilit gjaku filtrohet me anë të një aparature.



Veshka e dërrit filloi të funksiononte menjëherë pas transplantimit dhe vazhdoi të punonte për 271 ditë, përpara se të hiqej në tetor të vitit 2025. Pas kësaj, Andrews iu nënshtrua dializës për 82 ditë, derisa në janar 2026 mori një veshkë nga një dhurues njerëzor. Mjekët thonë se organi i ri po funksionon mirë.

5 Viti i shkollor nis edhe në burgun e Korçës, 31 të dënuar ndjekin...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Veshka e modifikuar gjenetikisht

Transplanti është pjesë e kërkimeve mbi ksenotransplantimin, pra përdorimin e organeve të kafshëve për transplant tek njerëzit.

Studiuesit përdorën derra të vegjël të racës Yucatan, organet e të cilëve janë modifikuar gjenetikisht për t'i bërë më të pranueshme nga organizmi i njeriut. Në total, janë kryer 69 modifikime gjenomike për të reduktuar rrezikun e refuzimit të organit dhe infeksioneve.

Megjithatë, rreth gjashtë muaj pas transplantimit, enët e gjakut në veshkë nisën të dëmtoheshin. Organi u inflamua dhe më pas filloi të dështonte. Mjekët nuk kanë përcaktuar ende saktësisht shkakun, pasi nuk u gjetën shenja të sulmit nga antitruapat kundër veshkës së derrit.

Sipas Dr. Leonardo Riella, nga Mass General Brigham, mungesa e organeve për transplant ka krijuar një "krizë" dhe ksenotransplantimi mund të ofrojë një alternativë për pacientët që nuk kanë një dhurues të gjallë.

Mijëra pacientë presin një veshkë

Në SHBA, rreth 100 mijë persona janë në pritje të një transplant veshke, ndërsa kryhen vetëm rreth 25 mijë transplante në vit. Në Britani, më shumë se 7 mijë persona janë në listën e pritjes për transplant veshke.




Andrews ishte informuar se mund të priste deri në shtatë vite për një organ njerëzor. Ndërkohë, sipas tij, jeta me dializë mund të ishte tepër e vështirë.

"Shpresa është gjëja më e madhe, mundësia për të qenë i lirë nga aparatura e dializës dhe për të jetuar jetën tënde", tha ai.

Rasti, i publikuar në revistën shkencore The Lancet, konsiderohet një hap i rëndësishëm në fushën e ksenotransplantimit, por mjekët theksojnë se mbeten ende sfida të mëdha përpara se organet e kafshëve të mund të përdoren gjerësisht te njerëzit.





#derr

#transplane

#veshke

**Xhuljana Zhuleku**

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh

BOTA

Huthët
përshkallëzojnë...

Xhuljana Zhuleku 34 minuta më parë

BOTA

Zelensky: SHBA
kërkuan ndërprerje t...

Xhuljana Zhuleku Sot 00:21

BOTA

Pezeshkian: SHBA
synon kolapsin socia...

Xhuljana Zhuleku Dje 23:55



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE

**Lajme**

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.